



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0057834/22-5 dt. 29.06.2022

Mitrovicë

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, dhe nenin 40, paragrafi 2, nënparagrafi b dhe c, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe nenin 46, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, të Statutit të Komunës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 29.06.2022, pasi shqyrtoi Propozim-vendimin për miratim të transferit Nr. 02-400/01-0055677 dt. 14.06.2022, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0055327/22-5 dt. 21.06.2022); sjell këtë:

VENDIM

Për miratimin e transferit të mjeteve të mbetura financiare

1. Miratohet Vendimi për transferim e mjeteve financiare në shumë prej 131,273.48 €, të mbetura nga projektet e planifikuara kapitale.
2. Sipas pikës 1. të këtij vendimi transferohen mjetet e mbetura nga projektet si në vijim:
 - 2.1. 21/642/48022/300/45945/0411 - *Asfaltimi, rregullimi dhe riparimi i rrugëve, në shumë prej 22,501.52 €*
 - 2.2. 21/642/48022/300/47097/0411 - *Ndërtimi dhe riparimi i rrugëve dhe trotuareve në qytet, në shumë prej 8,771.96 €*
 - 2.3. 10/642/17522/300/51925/0112 - *Sistemi i menaxhimit komunal, në shumë prej 60,000.00 €*
 - 2.4. 10/642/66115/300/51945/0620 - *Rregullimi i hapësirave në treg, në shumë prej 40,000.00 €*
3. Mjetet e mbetura nga projektet, të cekura në pikën 2. të këtij vendimi transferohen në projektet kapitale si në vijim:
 - 3.1. 10/642/66115/300/51944/0620 - *Rregullimi i shtëpisë së peshkatarëve, në shumë prej 25,000.00 €.*
 - 3.2. 10/642/48022/300/51934/0411 - *Pajisje motorike për pastrimin e Liqenit, në shumë prej 50,000.00 €.*
 - 3.3. 10/642/16322/300/51923/0133 - *Renovimi i objektit të komunës, në shumë 5,000.00 €.*
 - 3.4. 21/642/16322/300/51923/0133 - *Renovimi i objektit të komunës, në shumë 31,273.48 €.*
 - 3.5. 10/642/18466/300/51928/0320 - *Ndërtimi, rregullimi dhe riparimi i pjesëve të dëmtuara të rrugëve dhe objekteve në qytet dhe rrethinë, në shumë prej 20,000.00 €*
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik.
5. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesueses së Kuvendit
- 1 x 1 MAP
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
- Të gjitha drejtorive



Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA